



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Elbasan, më . . . 2025

Procesverbal -Tipi i kontrates - Mall

(Për argumentimin e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit)

OBJEKTI I PROÇEDURËS - “Stacione Autobuzi SMART”.

LLOJI PROÇEDURËS - “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë – Mallra”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi **CPV:** Ruter të rrjetit 32413100-2, Monitorë 33195100-4, Sisteme gps ose të ngjashme 38112100-4, Paketa software dhe sisteme informacioni 48000000-8, Servera 48820000-2, Ekrane 32351200-0

VLERA E FONDIT LIMIT - 19,040,331 (nëntëmbëdhjetë milion e dyzet mijë e treqind e tridhjetë e një) **lekë pa t.v.sh. ose 191,939** (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëqind e tridhjetë e nëntë) **Euro pa t.v.sh., i ndarë si mëposhtë:**

Fondi limit për: Ndërtimi i sistemit “Stacione Autobuzi SMART”: **17,940,331** (shtatëmbëdhjetë milion e nëntëqind e dyzet mijë e treqind e tridhjetë e një) **leke pa t.v.sh ose 180,850** (njëqind e tetëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë) **Euro pa t.v.sh.**

Fondi limit për: Mirëmbajtja e sistemit: **1,100,000** (një milion e njëqind mijë) **leke pa t.v.sh. ose 11,089** (njëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e nëntë) **Euro pa t.v.sh.**

Ne baze të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Elbasan ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipercituar, me përmbajtjen si mëposhte:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 të miratuara nga APP.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Kriteret (a-b) janë vendosur në përputhje me Dokumentat e Tenderit të miratuara nga APP bazuar në Vendimit Nr. 10 Datë 23.09.2024 si dhe bazuar në Ligjin Nr.162/2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar.

Pika a) bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Pika b) është vendosur në bazë të nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojces 8;

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë kopje të deklaratave të xhiros vjetore të leshuara nga administrata tatimore për gjatë tre viteve të fundit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se vlera e fondit limit** të prokuruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: në nenin 77, pika 3, e LPP parashikohet: Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Në pikën 1 dhe pikën 2/a të nenit 43 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: Pika1. Autoriteti/Enti Kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Vlera e kërkuar është një dëshmi e mjaftueshme për të krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomikë ofertues zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiar **2021, 2022, 2023**, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë

në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kriteri 2.2.2 është vendosur bazuar ne Nenin 77, pika 3 e LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr.10091,date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor,organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c. Në nenin 77, pika 3, e LPP parashikohet : autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Në nenin 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet te kete paguar taksat dhe tarifat vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi:Kriteri 2.2.3 eshte vendosur bazuar ne nenin 76, pika 2 te LPP sidhe ne ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se **40%** e vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvijës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasitë e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvija e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara ne organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri 2.3.1 është vendosur bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe nenin 40 pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Në pikën 4 të nenit 40 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti/Enti Kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së perlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarres duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar për tre muajt e fundit, si mëposhtë:

- a) **1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente).**

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga institucione të akredituara për shërbimet IT.

Çertifikime të njohura për menaxhimin e shërbimeve IT, por pa u kufizuar, janë:

- ITIL (Information Technology Infrastructure Library) – ITIL 4 Foundation ose më lart
- Certified Information Systems Manager (CISM)
- Certified in the Governance of Enterprise IT (CGEIT)
- ISO/IEC 20000 Foundation (Standardi Ndërkombëtar për Menaxhimin e Shërbimeve IT)
- COBIT 2019 Foundation (Control Objectives for Information and Related Technologies)
- Microsoft Certified: Enterprise Administrator Expert (për menaxhimin e shërbimeve IT në ekosistemin Microsoft)

Nuk do të pranohen çertifikata të përgjithshme trajnimi ose pjesëmarrje në kurse pa provim të akredituar apo çertifikata të nivelit bazik, të cilat nuk mbulojnë menaxhimin e plotë të shërbimeve IT.

- b) **1 (një) punonjës të certifikuar si zhvillues software ose ekuivalente**

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga institucione të akredituara në fushën e zhvillimit të aplikacioneve web dhe mobile.

Çertifikime të njohura për zhvillues software, por pa u kufizuar, janë:

- Microsoft Certified: Azure Developer Associate
- Oracle Certified Professional, Java SE Developer
- AWS Certified Developer – Associate
- Google Professional Cloud Developer
- Certified Kubernetes Application Developer (CKAD)
- Scrum Developer Certified (SDC) (për metodologji Agile në zhvillim software)
- Zend Certified PHP Engineer (për zhvillim në PHP)

Nuk do të pranohen çertifikata të përgjithshme trajnimi ose pjesëmarrje në kurse pa provim të akredituar apo çertifikata të nivelit bazik ose hyrëse, si p.sh. Microsoft Technology Associate (MTA) për zhvillim software.

- c) **1 (një) punonjës të certifikuar në Network në nivel Profesional ose ekuivalente.**

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga institucione të akredituara në fushën e rrjeteve, të tillë si, por pa u kufizuar:

- Cisco Certified Network Professional (CCNP)
- Juniper Networks Certified Professional (JNCIP)
- CompTIA Network+ (niveli i avancuar, jo bazik)
- MikroTik Certified Network Professional (MTCNP)
- Aruba Certified Network Professional (ACNP)
- Palo Alto Networks Certified Network Security Engineer (PCNSE)

Nuk do të pranohen certifikata të përgjithshme trajnimi ose pjesëmarrje në kurse pa provim të akredituar apo **certifikata të nivelit bazik** që nuk konsiderohen profesionale, si p.sh. CCNA, JNCIA.

d) 1 (një) punonjës të certifikuar për menaxhimin e pajisjeve server ose ekuivalente

Çertifikata duhet të jetë lëshuar nga institucione te akredituara në fushën e administrimit dhe menaxhimit të serverëve, duke përfshirë konfigurimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e tyre.

Çertifikime të njohura për administrimin e serverave, por pa u kufizuar, janë:

- Microsoft Certified: Windows Server Hybrid Administrator Associate
- Red Hat Certified Engineer (RHCE) (për administrimin e serverëve Linux)
- CompTIA Server+
- VMware Certified Professional – Data Center Virtualization (VCP-DCV)
- Cisco Certified Network Professional (CCNP) Data Center
- Dell EMC Proven Professional – Specialist – Infrastructure Security
- HP Accredited Technical Professional (ATP) – Server Solutions
- Lenovo Certified Data Center Technical Sales Professional

Nuk do të pranohen certifikata të përgjithshme trajnimi ose pjesëmarrje në kurse pa provim të akredituar apo **certifikata të nivelit bazik** që nuk konsiderohen profesionale.

- e) 2 (dy) punonjes elektrikistë** te pajisur me certifikatë kualifikimi profesional si dhe me deshmi kualifikimi të sigurimit teknik lëshuar nga I.SH.T.I. ose nga institucione ekuivalente të akredituara.

Shenim: Ky kusht mund te plotesohet edhe nese nje punonjes mund te zoteroje me shume se nje certifikate.

Për punonjësit, përveç certifikatave duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme dhe si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit. Çertifikatat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.SH”, i ndryshuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipër do të dorëzohet nga

ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kriteri 2.3.2 është vendosur bazuar në nenin të 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, konkretisht gjate punimeve qe duhet te kryhen per instalimin/konfigurimin e pajisjeve si dhe gjate periudhes se mirembajtjes te parashikuar ne specifikimet teknike dhe termat e references. Ne nenin 77 pika 4 te LPP nr.162, date 23.12.2020 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. Në nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet: *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:**

- a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose
- c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Per piken a): Për të siguruar një funksionim të suksesshëm të kontratës dhe për të mbajtur cilësinë e ofrimit të shërbimeve IT, është e domosdoshme që menaxhimi i tyre të kryhet në përputhje me praktikat më të mira dhe standardet ndërkombëtare. Kërkesa për një punonjës të certifikuar për “ITIL” ose ekuivalente lidhet me rezultatet që duhet të përmbushen nga Operatori Ekonomik, sipas kërkesave për realizimin e projektit ku përcaktohen kohët e ndërhyrjeve dhe termat e tjera të nivelit të shërbimit të mirembajtjes. Një certifikim “ITIL” ose ekuivalente është një set praktikash dhe rregullash dhe për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit si pjesë e qëllimit të projektit. Kërkesa për certifikim ITIL ose ekuivalente, i

dëshmon autoritetit që operatori ekonomik, nëpërmjet stafit të certifikuar si më sipër, garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të projektit në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes duke optimizuar përdorimin e burimeve teknologjike dhe duke rritur efikasitetin operativ të sistemit.

Per piken b): Bazuar në kërkesat e procedurës sipas objektit të prokurimit, operatori ekonomik duhet të kenë të paktën 1 punonjës të certifikuar si zhvillues software në nivel profesional për të siguruar cilësinë dhe përputhshmërinë e produkteve software me standardet më të larta për implementimin dhe mirëmbajtjen e zgjidhjeve software të cilat janë objekt i kësaj kontrate. Zhvilluesit e certifikuar kanë ekspertizën e duhur teknike për të zgjidhur problemet komplekse të implementimit dhe mirëmbajtjes së zgjidhjeve software, të cilat janë thelbësore për suksesin e projektit. Certifikimi i tyre garanton që ata zotërojnë njohuri të avancuara mbi praktikën më të mira në zhvillimin e software-it, si dhe përgatitjen për të ofruar zgjidhje të sigurt dhe të optimizuara. Për më tepër, duke qenë se ky projekt përfshin fazë të ndryshme zhvillimi dhe mirëmbajtjeje, kërkojnë zhvillues që të jenë në gjendje të ndërveprojnë me teknologjitë më të fundit dhe të jenë të përgatitur për të reaguar shpejt ndaj çdo lloj problemi teknik që mund të lindë. Për të përmbushur kërkesat e kontratës sipas objektit të prokurimit është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë në dispozicion zhvillues të certifikuar që të garantojnë suksesin e projektit në çdo fazë.

Per piken c): Kjo kontratë ka për detyrë të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet fizike Hardware Router/Firewall të një infrastrukture kritike me disponueshmëri shumë të lartë 24/7, për këtë arsye është kërkuar që personeli të jetë i certifikuar në Network për të përmbushur sa më mirë instalimin dhe shërbimin e mirëmbajtjes. Gjithashtu bazuar në qëllimin e punës së kësaj kontrate operatori ekonomik ka për detyrë të kryejë përmirësime të infrastrukturës fizike, pra është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë persona të specializuar për menaxhimin dhe implementimin e pajisjeve Network.

Per piken d): Kjo kontratë ka për detyrë të instalojë dhe mirëmbajë pajisjet fizike Hardware Server të një infrastrukture kritike me disponueshmëri shumë të lartë 24/7, për këtë arsye është kërkuar që personeli të jetë i certifikuar në Server për të përmbushur sa më mirë instalimin dhe shërbimin e mirëmbajtjes. Gjithashtu bazuar në qëllimin e punës së kësaj kontrate operatori ekonomik ka për detyrë të kryejë përmirësime të infrastrukturës fizike, pra është e nevojshme që operatori ekonomik të ketë persona të specializuar për menaxhimin dhe implementimin e pajisjeve servera.

Per piken e): Duke qenë se gjatë zbatimit të projektit do të bëhen dhe instalime elektrike do të duhet që operatori ekonomik të ketë pjesë të stafit të tij 2 (dy) punonjës elektrikiste të pajisur me certifikatë kualifikimi profesional si dhe me certifikatë kualifikimi të sigurimit teknik në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, i ndryshuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet te disponoje dhe te paraqese certifikaten e vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 “Sistemi i Menaxhimit te Cilesise” ose ekuivalente, e vlefshme
- SSH/EN-ISO 27001 “Sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit” ose ekuivalente, e vlefshme
- SSH/EN-ISO 20000-1 “Për menaxhimin e shërbimeve te teknologjise se informacionit” ose ekuivalente, e vlefshme

Certifikata e mesiperme duhet te jete e leshuar nga nje organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet te dorezoje certifikata ISO sipas zërave te punëve/mallrave/shërbimeve qe do te marr përsipër te realizoje sipas akt-marrëveshjes paraprake.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Në nenin 79, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nder te tjera parashikohet se : Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

Në nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, nder te tjera parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Certifikimi ISO 9001 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë në mënyrë cilesore dhe të plotë, bazuar në organizimin e brendshëm për menaxhimin sa më të mirë të cilësive implementuese. Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rendesinë e funksionalitetit të sistemeve që do të instalohen.

Certifikimi ISO 27001 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke siguruar që informacionet (siç janë ato që përmbajnë sistemet ekzistuese të AK dhe e kanë një rendesi dhe konfidencialitet të lartë) të menaxhohen në mënyrë të sigurtë nga pikepamja informatike dhe të jenë të kontrolluara dhe si dhe aksesit mbi to të jetë i verifikueshëm e i kodifikuar). Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rendesinë e funksionalitetit të sistemeve që do të instalohen.

Certifikimi ISO 20001-1 ose ekuivalent shërben për të verifikuar dhe garantuar që OE i interesuar është në gjendje të kryejë realizimin e kontratës në fjalë duke qenë se zoteron një sistem menaxhimi për shërbimet e teknologjisë së informacionit, duke pasur me shumë garanci që ky i fundit të planifikojë, krijojë, zbatojë, monitorojë, rishikojë, mirëmbajë dhe përmirësojë të gjithë sistemin në teresi i cili është teresisht i bazuar në produkte TIK (software dhe hardware). Ky certifikim kërket në përputhje me proporcionalitetin e vlerës së fondit limit të venë në dispozicion dhe bazuar në kompleksitetin dhe rendesinë e funksionalitetit të sistemeve që do të instalohen.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë fotografi/katalogë/broshurë ose fragmente (faqe) të katalogut/eve për pajisjet **Server, Routerat, Firewall, Pajisjet Gjurmuese GPS** duke markuar në mënyrë të qartë dhe të dallueshme pajisjet që oferton, me specifikimet përkatëse të markuara, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria me kërkesat në DT, si dhe të plotësohen të dhënat sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i mallrave	Modeli i pajisjes	Emri i prodhuesit	Titujt e katalogeve, nr. faqes së katalogëve për çdo pajisje të ofruar, etj.	Faqja zyrtare e internetit e prodhuesit
-----	---------------------	-------------------	-------------------	--	---

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit catalog dhe cilit prodhues i përket.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6/b, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur për të garantuar Autoritetin Kontraktor se artikujt e ofruar do të jenë prodhim i të njëjtës kompani me atë të deklaruar në ofertë dhe që përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike.

2.3.5 Në rast se operatori ekonomik ofertues nuk është prodhues, ai duhet të paraqesë kontratë furnizimi materiale/autorizim nga prodhuesi ose distributor zyrtar për mallin objekt prokurimi. Në rastin e kontratës së furnizimit/autorizimit me distributorin të dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin. Kontrata/autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme nga Autoriteti Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pika 6 b), pikën 8, të nenit 40, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi apo nga distributori i autorizuar i tyre. Kështu autorizimi i prodhuesit apo distributorit të autorizuar, tregon nëse OE kanë mundësinë të ofrojnë mallra origjinale, në cilësi dhe me standarde ndërkombëtare, duke garantuar mbështetjen e kompanisë prodhuese/distributore gjatë procesit të furnizimit/vendosjes e instalimit dhe mirëmbajtjes gjatë periudhës së garancisë, si dhe me qëllim verifikimin e origjinës së mallrave dhe të dhënave të tjera të deklaruara mbi prodhuesin.

2.3.6. Ditën e dhe orën e hapjes së ofertave, ofertuesit duhet të dorëzojnë në Bashkinë Elbasan, kati III, sektori IT, mostra për pajisjet: Router dhe GPS për mjetet e transportit, të cilat duhet të jenë sipas specifikimeve të kërkuara. Mosdorëzimi i mostrave apo dorëzimi jo në përputhje me specifikimet teknike përbën kusht s’kualifikues.

Argumentimi: Kriteri **2.3.6** është vendosur në përputhje me Nenin 40 pika **6**, germa **b)** të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit kontraktor për të gjykuar me mirë mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për objektet që prokurohen, me qëllim që, cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara prej tij. Janë kërkuar mostrat për pajisjet Router dhe GPS të vlerësuara nga AK si pajisje kryesore për të realizuar me sukses objektin e prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një zgjidhje teknike, në të cilën të përfshihet propozimi i një draft plani të detajuar për shërbimet e implementimit dhe konfigurimit të pajisjeve dhe sistemeve që janë objekt prokurimi. Zgjidhja teknike duhet të jetë e përputhshme me specifikimet teknike dhe grafikun.

Argumentimi: Kriteri **2.3.7** është vendosur në përputhje me Nenin 40 pika **8**, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Një **dokument teknik i zgjidhjes** është thelbësor për disa arsye kryesore:

1. Siguron qartësi dhe strukturë

Dokumenti ofron një plan të detajuar për implementimin dhe konfigurimin e pajisjeve dhe sistemeve, duke shmangur paqartësitë dhe keqkuptimet mes palëve të përfshira.

2. Demonstron përputhshmërinë me kërkesat e prokurimit

Një zgjidhje teknike e mirë-dokumentuar tregon se operatori ekonomik ka kuptuar kërkesat e prokurimit dhe është në gjendje t'i përmbushë ato sipas specifikimeve të kërkuara.

3. Lehtëson vlerësimin nga autoritetet kontraktore

Një dokument teknik i detajuar ndihmon autoritetin prokurues të vlerësojë aftësinë teknike të operatorit ekonomik, duke bërë të qartë mënyrën se si do të zbatohet projekti.

4. Siguron efikasitet dhe menaxhim të suksesshëm të projektit

Duke përfshirë një plan të qartë për fazat e implementimit, burimet e nevojshme dhe afatet kohore, dokumenti ndihmon në menaxhimin më të mirë të projektit dhe shmang vonesat.

5. Lehtëson komunikimin dhe koordinimin

Një dokument teknik i mirë-strukturuar ndihmon në koordinimin mes ekipeve të ndryshme që do të punojnë në projekt, si teknologjia e informacionit, inxhinierët e rrjetit dhe menaxherët e projektit.

6. Tregon profesionalizëm dhe ekspertizë

Një dokument teknik i detajuar pasqyron seriozitetin dhe përgatitjen e operatorit ekonomik, duke rritur besueshmërinë dhe shanset për të fituar kontratën.

Në përfundim, një **zgjidhje teknike e dokumentuar** nuk është vetëm një kërkesë formale, por një mjet strategjik që ndihmon në sigurimin e suksesit të projektit, nga faza e planifikimit deri në ekzekutim dhe mirëmbajtje.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentim: Në bazë të nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 15, pika 3/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Specifikimet teknike janë hartuar nga specialisti fushes, anetar i njesise se prokurimit. Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara si dhe janë në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

NJESIA E PROKURIMIT